



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 11, datë 31.01.2019

PËR

**REFUZIMIN E KËRKESËS PËR RISHIKIM TË VENDIMIT TË BORDIT TË
AMF-SË NR. 260, DATË 28.12.2018**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar dhe Kodit të Procedurës Administrative, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

K O N S T A T O I S E:

Bordi i Autoritetit bazuar në nenin 45 të Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i ndryshuar, me Vendimin nr. 260, datë 28.12.2018, ka vendosur shumën e kontributeve të Fondit të Kompensimit për vitin 2019, në masën 556,461,885 lekë.

Në vendimin e Bordit është përcaktuar dhe krijimi i provigjonit për shpenzime të shumës prej 382,784,517 lekë, e cila i korrespondon vlerës së dëmeve për praktikatat ende në proces si dhe është përcaktuar detyrimi i shoqërive të sigurimit për derdhjen e Fondit të Kompensimit në llogarinë qëllimore.

Vendimi i Autoritetit i është njoftuar shoqërive të sigurimit anëtare të BSHS-së, Kryetarit të Këshillit Administrativ si dhe Drejtorit Ekzekutiv të BSHS-së me shkresën nr. 20 prot., datë 07.01.2019.

Byroja Shqiptare e Sigurimit me shkresën nr. 253 prot., datë 14.01.2019, ka depozituar kërkesën për rishikim të Vendimit të Bordit nr. 260, datë 28.12.2018 “Mbi fondin e kompensimit për vitin 2019”, si dhe ka depozituar me shkresën nr. 355 prot., datë 18.01.2019, Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve nr. 01, datë 11.01.2019 “Për miratimin e masës së kontributit vjetor për fondin e kompensimit”, ku propozon shumën prej 313,000,000 lekë Fond Kompensimi për vitin 2019.

Kërkesa e depozituar në përmbajtje paraqet dhe elementë që lidhen me ankimin administrativ.

Autoriteti shqyrtoi shkaqet e parashtruara në këtë kërkesë dhe konkludoi se:

I gjithë procesi i vendimmarrjes është kryer nga Autoriteti në përputhje të plotë me kompetencat e parashikuara në nenin 45 e vijues të Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i ndryshuar.

Autoriteti në përcaktimin e shumës së kontributit të Fondit të Kompensimit për vitin 2019, i është referuar të dhënave mbi të cilin ka gjykuar se fondi i propozuar është i pamjaftueshëm dhe nuk arrin të përballojë pagesat e Fondit të Kompensimit.

Në këto kushte, kërkesa për rishikim të Vendimit nr. 260, datë 28.12.2018 duke përcaktuar në pikën 1 të saj një vlerë tjetër të Fondit të Kompensimit, siç propozohet nga BSHS nuk mund të realizohet.

Për sa më sipër, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Refuzimin e kërkesës për rishikimin e Vendimit të Autoritetit nr. 260, datë 28.12.2018 “Mbi fondin e kompensimit për vitin 2019”.
2. Lënien në fuqi të vendimit të Autoritetit nr. 260, datë 28.12.2018 “Mbi fondin e kompensimit për vitin 2019”.
3. Ngarkohen Departamentet përkatëse për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Pajtim MELANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin KOÇI